



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 13747 Prot

Lezhë, më 01 / 09 /2023

**VENDIM**

**Nr. 32, Datë 30. 08. 2023**

**Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin e KB nr.120, datë 02.12.2022 “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”; shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.6717, datë 04.07.2023 “Akordimi i fondeve për financimin e ofrimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në nivel qarku dhe bashkie”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

**Vendosi :**

1.Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve si më poshtë:

1/1.Në pikën 1, të vendimit KB nr.120, datë 02.12.2022 “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023, bëhet ky ndryshim:

- Në pikën 1/a-Shtohen burimet në:- Gr.13, Prog.10430, Kap.01, Art.606 në shumën 2,201,108 lekë.
- Në pikën 1/b-Shtohen shpenzimet në : -Gr.13, Prog.10430, Kap.01, Art.606 në shumën 2,201,108 lekë për mbulimin e shpenzimeve të:
  - a- 4 punonjësve me kontratë 6 mujore : paga në shumën 1,495,380 lekë dhe sigurime shoqërore në shumën 249,728 lekë.
  - b- 2 punonjësve socialë me kohë të pjesshme: paga në shumën 390,746 lekë dhe sigurime shoqërore në shumën 65,254 lekë.

1/2. Në pikën 4, të vendimit KB nr.120, datë 02.12.2022 “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023, bëhet ky ndryshim: Shtohen 4 punonjës me kontratë 6 mujore me kohë të plotë dhe 2 punonjës me kohë të pjesshme.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI**

**NDUE LULI**



Prot 13747/1

DT 8.9.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KB

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 685/18 Prot.

Lezhë, më 06 .09 .2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16, pika 2, gërma "b" të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", në ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në ligjin nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr.9936, datë 26.08.2008 "Për menagjimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.32, datë 30.08.2023, të këshillit të bashkisë Lezhë "Për disa shtesa e ndryshime në vendimin e KB nr.120, datë 02.12.2022 "Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe buxhetit të vitit 2023".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

